



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:177489

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05622154

2023:192672

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çështjen penale ndaj të pandehurit G.R nga Kaçaniku, i akuzuar për veprën penale, Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/IL.nr.1128/23 të dt.08.09.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datë 17.04.2024, në prezencë të Prokurorit të shtetit Ardian Emmini, të dëmtuarës dhe të pandehurit, me mbrojtësin e tij me autorizim, av.Sh. V., më datë 22.04.2024 mori dhe shpalli, ndërsa më datë 25.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri E. B. nga Kaçaniku, Lagjia "... "pn. , i lindur më dt.... nga i ati S... dhe e ëma M... , e gjinisë K..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së mirë ekonomike, me nr. personal: ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 20 Gusht 2023, rreth orës 01:00, me dashje ka përdorur forcën duke e sulmuar fizikisht të dëmtuarën R. G., me të cilën ka qenë në lidhje dashurie, ashtu që fillimisht janë takuar në afërsi të shtëpisë së të dëmtuarës, pastaj me kamionetën e të pandehurit shkojnë në

fshatin Stagovë, Komuna Kaçanik, dhe derisa kanë qenë duke biseduar kanë filluar të fjalosen dhe e dëmtuara ka kërkuar nga i pandehuri që t'a dërgojë te shtëpia dhe pasi janë nisur në drejtim të fshatit ..., është ndalur te vendi i quajtur "te bazenti i fshatit" duke i thënë zbrit, e dëmtuara ka refuzuar të zbresë në këtë vend, pastaj i pandehuri duke përdor forcën e kap për duar duke e tërhequr nga vetja dhe derisa e dëmtuara ka rezistuar në këto momente e sulmon fizikisht duke e goditur me shuplakë në fytyrë, pastaj dhunshëm e zbrit nga kamioneta dhe sërish e godet me shuplakë në veshin e anës e majtë, ka ndier dhimbje dhe ka bërtitur, në këto momente dhunshëm e fut në kamionet dhe me një shpejtësi të madhe nisur në drejtim të fshatit ... dhe është ndalur te fusha e futbollit, ka filluar t'a qortojë, e kap për flokë duke i thënë "çka mbane kështu", dhe e ka larguar nga kamioneta, i pandehuri është larguar dhe pas pak është kthyer dhe përsëri e ka takuar të dëmtuarën të cilës i ka thënë eja brenda në kamionet, pasi e dëmtuara ka hy në kamionet, i pandehuri është nisur në drejtim të fshatit S..., në këto momente e dëmtuara zbrit nga kamioneta dhe duke vrapuar në drejtim të parkingut të varrezave, aty ka qenë policia, të cilët pastaj e kanë arrestuar të pandehurin ndërsa të dëmtuarën e kanë dërguar në QKMF-Kaçanik,

Me këto veprime, i pandehuri ka kryer veprën penale, Sulmi nga neni 184 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,7,38,43,69,70,71 par.1 nenpar.1.3 të KPRK-së, nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 600.00 € (gjashtëqind euro), në të cilën do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 20.08.2023 deri më dt.28.08.2023 dhe në paraburgim nga data 28.08.2023 deri me dt.04.09.2023, ndërsa pjesën tjetër të dënimit me gjobë, I pandehuri është i obliguar që t'a paguajë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, ne afatin prej 30 ditësh pas plotfuqishmerise së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do t'a zevendesojë dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgimi.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 20.00€, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30€, ndërsa në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

E dëmtuara, Rinesa Guri, nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën: PP/II.nr.1128/23 të datës 08.09.2023, e akuzoi te pandehurin E. B. nga Kaçaniku, për veprën penale, Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Ne bazë të kësaj aktakuze gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.26.09.2023 me te cilin rast, I pandehuri , pas prezentimit te aktakuzës nga prokurori I shtetit, nuk e ka pranuar plotësisht fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Ne shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 17.04.2024, prokurori i shtetit Ardian Emini deklaroi se, mbetet ne tërësi pranë aktakuzës së parashtruar pranë kësaj gjykate, pa ndryshime dhe plotësime.

E dëmtuara R. G., në fjalën e saj në shqyrtimin gjyqësor, deklaroi se i bashkangjitet ndjekjes penale, ndërsa nuk parashtron kërkesë pasurore juridike dhe njëherit nuk pajtohet me propozimin e mbrojtësit të të pandehurit që çështja penale në fjalë të referohet në procedurë të ndërmjetësimit, dhe poashtu nuk pranon kërkimfaljen e të pandehurit.

I pandehuri në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, duke shprehur pendesë për veprimin e tij, duke i kërkuar falje të dëmtuarës dhe duke i premtuar të njëjtës por edhe gjykatës se veprime të tilla apo të ngjashme, nuk do të përsërisë në të ardhmen, prandaj edhe i ka kërkuar gjykatës, që me rastin e marrjes së vendimit, t'i shqiptohet një dënim sa më i ulët që të jetë e mundur.

Prokurori I shtetit, e dëmtuara dhe mbrojtësi i të pandehurit, nuk e kanë kundërshtuar pranimin e fajësise nga ana e të pandehurit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 322 lidhur me 242 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajesisë, se pranimi i fajesisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet ne faktet e çeshtjes që permban akuza, se akti akuzues nuk permban asnje shkelje te qartë ligjore apo gabime teknike andaj shqyrtimin gjyqësor e vazhdoi pa administrimin e provave tjera.

Prokurori i shtetit ne fjalen e tij përfundimtare deklaroi se, nga vetë pranimi I fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili vullnetarisht e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet ne barrë sipas aktakuzës, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv, andaj edhe i propozon gjykatës që të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'I shqiptojë sanksion penal sipas ligjit, duke patur parasysh si rrethanë rënduese, cenimin e integritetit trupor të të dëmtuarës, dhe faktin se kjo vepër penale po shfaqet si dukuri në shoqëri, ndërsa si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësie nga i pandehuri, dhe faktin se i njëjti nuk është përsëritës i kësaj vepre apo veprave tjera penale.

Mbrojtësi i të pandehurit në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se, pasi që i mbrojturi i tij, e pranoi fajësinë duke i kërkuar falje te dëmtuarës, dhe duke i premtuar gjykatës se ne te ardhmen nuk do të përsërisë këso veprime, i kërkon gjykatës që me rastin e matjes së dënimit, si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, të bërë në mënyrë të singertë, rolin relativisht të vogël, gjatë kryerjes së veprës penale, andaj ndaj te njëjtit, mbi këto baza t'i shqiptojë një dënim me gjobë, në të cilin t'i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak dhe në paraburgim, duke vlerësuar se edhe me këtë lloj të dënimit, do të arrihet qëllimi i plotë i dënimit, duke shërbyer si preventivë ne te ardhmen, që i mbrojturi i tij, mos te kryerj ndonjë vepër tjetër penale.

I pandehuri ne fjalën e tij, pajtohet ne tërësi me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka diçka tjetër për të shtuar .

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit, manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, konform nenit 70 te KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilen e ngarkon aktakuza në

senacën e parë të shqyrtimit gjyqesor, ka premtuar para gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, bazuar në evidencën e gjykatës i njëjti nuk ka patur raste të tjera penale, ndërsa si rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti faktin se ditën kritike i pandehuri disa herë kishte përdorur dhunë ndaj të dëmtuarës, duke i shkaktuar të njëjtës frikë dhe pasiguri.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin E. B., i akuzuar për veprën penale, Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë tek i pandehuri dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

E dëmtuara, R. G., nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Bazuar në të lartëcekurat, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

2023: 192672 datë 25.04.2024

Sekretarja Juridike,
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.